



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 066/2020

Nr. Protokolli: 130/2020

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik TRIANGLE SH.P.K.; Globi - M.I. SH.P.K., rr.Brigada123, 23000, Suharekë
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	20/10/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 14.10.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik TRIANGLE SH.P.K.; Globi - M.I. SH.P.K., rr.Brigada123, 23000, Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Projekt me bashfinancim -Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqeve në fshatrat e Komunës së Suharekës”** me Nr. të Prokurimi: 624-20-2918-5-2-1& 624-020-057-521nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës 14.10.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Grup i Operatorëve Ekonomik TRIANGLE SH.P.K.; Globi - M.I. SH.P.K., rr.Brigada123, 23000, Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Projekt me bashfinancim -Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqeve në fshatrat e Komunës së Suharekës”** me Nr. të Prokurimi: 624-20-2918-5-2-1& 624-020-057-521 Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 09.10.2020 të publikuar në platformen elektronike.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 09.10.2020

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 14.10.2020, ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Projekt me bashfinancim -Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqeve në fshatrat e Komunës së Suharekës**” me Nr. të Prokurimi: **624-20-2918-5-2-1& 624-020-057-521** kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të datës 10.09.2020 të publikuar në platformen elektronike

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, konform Ligjit të Prokurimit Publik dhe RRUOPP duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar sipas DT.

Pretendimi i OE ankues, lidhur me çështjen e CV- për Ekologen Valboma Kryeziu nuk qëndron. Bazuar në Nenin 39 i RRUOPP, Nenit 72, dhe 69 të LPP-së, Ak-Suharekë, ka kërkuar sqarim pasi CV nuk përmban informatat e kërkuara,kjo konform dispozitave të shënuar, konkretisht neni 39 I RRUOPP, i cili citon:

CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara	AK nuk mund te vendos Mund te kërkohe informatat sqaruese	Neni 69
--	---	---------

Pretendimi ankimor sa i përket paisjeve të kërkuara për implementimin e projektit, është i paqëndrueshëm, për arsye se OE i rekomenduar për kontratë, në bazë të dokumentacionit të ofruar dhe sqarimeve të ofruara, i posedon të gjitha paisjet e nevojshme te kërkuara në FDT. Po ashtu, përveç marrëveshjes që ka me kompanin N.T. Pleqja dhe të tjerë, ne nga këta OE kemi pranuar edhe email, ku OE të rekomanduar për kontratë e mbështesin me paisjet e kërkuara.

Pretendimi ankimor lidhur me validitetin certifikatave për lodra është i paqëndrueshëm, sepse OE, pas kërkesës tonë i ka sjellë te gjitha sqarimet të cilat për ne janë të pranueshme.

Pretendimi ankimor se ne ju kemi eliminuar padrejtësisht, është i paqëndrueshëm, sipas Komisionit të ri-vlerësimit, ju nuk i keni sjellë dëshmit e kërkuara konform kërkesave tona.

Kjo për shkak se:

Qe nje product te jete I certifikuar duhet qe prodhuesi te ndjeke keta hapa sipas standardit rregulloreve dhe ligjit te ndertimit si ne vijim:

- 1/ Per pllaka teraco stanardi perkates eshte EN 13748-1-2
- 2/ Prodhuesi duhet te jete I certifikuar me Sistemin per Menaxhimin e Kontrollit te Cilesise ISO 9001-2015
- 3/ Te kete marreveshje me laborator te jashtem te akredituar per standardin EN 13748-2 per kontrollin e fabrikes dhe prodhimit.
shih **LIGJI Nr. 06/L-033**
1.27. **Kontrolli i prodhimit në fabrikë** - kontrolli i dokumentuar, i përhershëm dhe i brendshëm i prodhimit në një fabrikë në përputhje me specifikimet teknike të harmonizuara përkatëse;
- 4/ Pas testimit te materialeve leshohet certifikata e atestit nga Laboratori dhe me vlerat e kesaj certificate plotesohet Dekalara e Performances CE per produktin.. (Kjo deklarate leshohet vetem per nje product perkates dhe nese jane dy produkte leshohen dy deklarata dhe keshtu me radhe) shih **LIGJI Nr. 06/L-033**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.



u.d. Shef i Prokurimit
Afrim BYTYQI